



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 22/2009
Më 14. 07. 2009, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Kaqusha Jashari, Mufëra Şinik, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Safete Hadërgjonaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Justina Pula – Shiroka, Sarah Rexhepi dhe Arizona Berdynaj MEM dhe Besim Zeqiri - ICO.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 07. 07. 2009;
3. Raporti i MEM-it për projektin “Kosova e Re”;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 07. 07. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 07. 07. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Raporti i MEM-it për projektin “Kosova e Re”

Kryetarja – Ia dha fjalën znj. Pula – Shiroka të raportonte për projektin “Kosova e Re”.

Justina Pula – Shiroka - ministre e Ministrisë së Energjisë dhe e Minierave (MEM) – Theksoi se koncepti për termocentralin “Kosova e Re” ka filluar para dy vjetësh. Me ardhjen e Qeverisë Thaçi janë diskutuar dhe janë analizuar ato dokumente të cilat janë gjetur. Gjatë diskutimit me Qeverinë dhe me grupet e tjera, të formuara, kemi ardhur deri diku të ndryshimi sa i përket konceptit për termocentralin “Kosova e Re”. Opsioni “Kosova e Re” ka qenë të ndërtohet Termocentrali 2100 MG dhe të jepet me koncesion në përgjithësi termocentrali. Ndërkohë, më bisedë e sipër, kemi ardhur në përfundim që kapacitetet të zvogëlohen dhe të shikohet mundësia për dhënien e Sibovci me koncesion. Sa i përket kohës se koncesionit dhe hapësirës, në kuadrin e pakos ka pasur dilema të ndryshme: A të përfshihet Termocentrali Kosova A dhe B në këtë pako apo të mbetet, siç ka mbetur jashtë këtij projekti dhe të ndërtohet vetëm termocentrali “Kosova e Re”. Për Kosovën A dhe B kemi qasje. Me direktivat e BE-se, Kosova A duhet të mbyllet. Në qoftë se e ndajmë Termocentralin B, atëherë e ndalim monopolin që mund të jetë në Kosovë. Arsyeja tjetër pse i kemi zvogëluar kapacitetet e 2100 MG-ve, ka qenë se i kemi pasur disa vërejtje nga Komisioni Evropian. Njoftoi se janë duke u hartuar tri (3) projektligje: për energjinë, për energjinë elektrike, dhe për rregullatorin. Po ashtu njoftoi se është duke u punuar në strategjinë 2009 - 2018 dhe është duke u finalizuar koncepti i saj që shumë shpejt do të vijë në Kuvend për diskutim dhe për miratim. Më tej shtoi se termocentrali “Kosova e Re” do të jetë i pavarur nga shteti, do ta ketë në shfrytëzim mihjen e Sibovcit dhe do të ndërtohet sipas kapaciteteve të cilat i parashikojmë edhe ne. Njoftoi se do të nisë nga e para, do të lidhet marrëveshja për 1000 MG, do të thotë 500 plus 500 MG, me kusht që nëse ndërtohet brenda një kohe të shkurtër - distanca kohore të jetë një vit e 7 muaj. Ndërkaq sa i përket Sibovcit, është propozuar të jepet për shfrytëzim komplet për “Kosovën e Re”. Mirëpo në Këshillin Drejtues është diskutuar se mund të vendoset vetëm për 1000 MG, sepse nevojat tani nuk janë më të mëdha.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se debati në kuadër të Komisionit do t’i kontribuojë shumë përfundimit dhe vlerësimit të Projektit në fjalë. E falënderoi ministren për raportimin më përmbajtje të plotë. Shtoi se do të shihet më vonë se sa duhet të investohet dhe si të rregullohet situata energjetike, ana ekonomike dhe pjesa e investimeve, që duhet t’i ruajë shteti, sepse janë çështje themelore. Sa i përket kapacitetit, edhe për Sibovcin, për mënyrën e menaxhimit, se në pronësi të kujt do të jetë Sibovci, po ashtu a do të mbetet Sibovci pasuri e shtetit apo me investime të përbashkëta me ndonjë kompani. Në këtë pikë duhet të kemi kujdes për ndryshimin e strategjisë dhe kur të dërgohet për miratim në

Kuvend të gjendet zgjidhje më e mirë dhe më e drejtë. Ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit debati duhet të zhvillohet në këtë mënyrë. Shtoi se duhet të kemi parasysh pozitën strategjike në rajon, duke marrë parasysh se edhe Shqipëria është duke ndërtuar çdo ditë termocentrale dhe hidrocentrale. Do të vazhdojmë të debatojmë se çka do të bëhet me Sibovcin. Ishte i pajtimit se nuk duhet t'i jepet në shfrytëzim ndonjë kompanie, por duhet të jetë në pronësinë e shtetit ose në partneritet publiko-privat dhe të jepet me koncesion, sepse në këtë mënyrë duhet të ruhet interesi i shtetit aty ku është forma më e mirë. Në fund tha se ka dilema sa i përket teknologjisë së re, që vjen në Kosovë, kriteret e standardeve, sepse i kemi parasysh vendet e tjera, se teknologjia e re paraqet përparim të madh dhe nuk duhet të humbim shumë kohë në këtë aspekt.

Berim Ramosaj – Paraqiti dilemën që zhvillimi ekonomik të mbështetet në resurset energjetike dhe dilemën e komunitetit lidhur me kapacitete, mirëpo në anën tjetër interesi i Kosovës është për zhvillim ekonomik edhe pse një kohë të gjatë jemi mbështetur në ndërmarrje dhe në biznesin e vogël. Kërkoj që Qeveria të marrë inpute nga komuniteti para se të merret vendimi. Është mirë të zhvillohen debate me ekspertë dhe me qytetarë, pse jo edhe debate publike me komunitetin, sepse kur të merren vendime kapitale duhet të jenë në interes të Kosovës dhe të merret parasysh zhvillimin ekonomik.

Kaqusha Jashari – Tha se nuk ishte e pajtimit të investohet shumë në kapacitete, që ta shfrytëzojmë pasurinë tonë, pa u harmonizuar me kapacitete të tjera. Në qoftë se përcaktohem për kapacitete të mëdha, është papërgjegjësi. Shtoi se e përkrah idenë e fundit, që ende nuk është përfunduar në 1000 MG, d.m.th. 500 + 500 MG, që e cilësoi si shumë reale, sepse nuk është për t'u pranuar 2100 MG. Në fund e përkrah idenë që Kosova A të mbyllet dhe Sibovci të shfrytëzohet me shumë kujdes, sepse minierat janë pasuri e shtetit dhe duhet të ruhen.

Ethem Çeku – Theksoi se problemi më i madh qëndron në rregullimin e pakos tenderuese. Strategjinë që është në diskutim duhet ta miratojë Kuvendi. Shtoi se strategjinë 2005 - 2015, të miratuar me kornizë, edhe Kuvendi e ka miratuar. Pra është vepruar sipas këtij parimi. Tani sërish duhet ta ndryshojmë strategjinë që duhet ta rregullojë dhe çështjen e pakos tenderuese. Sfidë më e madhe është harmonizimi i strategjisë së miratuar në Kuvend, pastaj hapet rruga e pakos tenderuese. Duke mos u lëshuar në detaje, tha se duhet të konsultohemi me ekspertë dhe me këshilltarë ligjorë dhe mjedisorë të transaksionit, se a do të këtë ujë. Të trajtohet se për 1000 apo 2000 MG ka apo nuk ka ujë, në Sibovc apo në Dardhishtë, ku të vendoset mundësia për koncesion. Tha se sfida më e madhe është harmonizimi i strategjisë dhe i pakos tenderuese dhe si e ka marrë Kuvendi përfundimin final. Në fund tha se i mbetet besnik projektit për 2100 MG, përderisa këtë e kanë thënë ekspertët. Vendimet politike janë vendime politike, mirëpo ende nuk është bërë një studim që do të sqaronte se Kosovës nuk i duhet një gjenerim kaq i madh, apo Kosovës nuk i nevojitet kaq, sepse blloku A po mbyllet, ndërsa B-ja do të këtë jetëgjatësi të shkurtër dhe blloqet e reja më në fund do të zëvendësohen.

Zef Morina – Tha se i vjen mirë që së shpejt do të fillojë puna për Projektin 500 plus 500 MG, sepse Kosova A është afër mbylljes. Nuk kemi arsye që për shkaqe të ndryshme ta pranojmë këtë projekt, qoftë për shkaqe strategjike apo për pako tenderuese, se këto

gjëra janë kryer më herët. Tash duhet vetëm të vazhdohet tutje. Në fund pyeti për hidrocentralin e Zhurit, në qoftë se jepet me koncesion termocentrali “Kosova e Re”, a do të ndërtohet edhe hidrocentrali i Zhurit, sepse mund të mos ketë interes të investohet.

Sala Berisha – Shala – Mendimi i saj është se nuk jemi vonuar, sepse së pari nuk kemi pasur infrastrukturë të duhur ligjore për rregullimin e këtyre çështjeve, pavarësisht që edhe mbështetësit tanë na kanë shtyrë që ta bëjmë strategjinë e mirëfilltë pa infrastrukturë ligjore dhe pa harmonizim me pozicionin e Kosovës për energjinë në rajon. Duke vlerësuar lart punën e Qeverisë, tha se vetë fakti për sinjalin e ndërtimit të hidrocentralit të Zhurit, dihet se është obligim të zhvillohet prodhimi i termoenergjisë, në një farë forme të zëvendësohen termocentralet me hidrocentrale, si alternative.

Myzejene Selmani – Kërkoj nga ministrja, pse nuk paraqet strategji për shqyrtim në seancë plenare, kur dihet se strategjia 2005 - 2012 është aprovuar në Legjislaturën e kaluar, por ka pasuar ndryshime. Kësaj strategjie duhet t’i bashkëngjiten ligjet e nevojshme dhe si do të vendoset për Letrën rekomanduese të marrë nga USAID-i, për këshilltaret e transaksionit, për çështjen e Sibovcit dhe për harmonizimin e strategjisë me pakon tenderuese.

Justina Pula – Shiroka - ministre e Ministrisë së Energjisë dhe e Minierave (MEM) – Duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, tha: Lidhur me Sibovcin jemi pajtuar që një pjesë t’i jepet në shfrytëzim investitorit, mirëpo në këtë zhvillim mendohet që edhe Kosova të jetë pjesë e procesit. Sibovci mbetet pjesë e gjatë e Projektit. Investitori do ta marrë pjesën më të madhe për shkak të Projektit dhe të mjeteve të investimeve; ndër investimet që janë bërë deri më tani, me riparimin e ekskavatorëve, me donacionet dhe kredinë që është marrë prej buxhetit të Kosovës; do të shihet së sa do të vlerësohen investimet e bëra deri me tani dhe automatikisht mbeten pjesë e Sibovcit; hidrocentrali i Zhurit parashihet të funksionojë vetëm në kohën e mëngjesit dhe të mbrëmjes kur kemi më së shumti nevojë, d.m.th të mbetet vetëm si arltenativë.

IV. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik

Kryetarja – Hapi debatin në parim për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet në parim Projektligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik.

V. Të ndryshme

Kryetarja – I njoftoi deputetët se në mbledhjen e radhës do të jetë në rend dite shqyrtimi në parim i Projektligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara dhe nëse konfirmohet nga USAID-i se do të jenë gati amendamentet për Projektligjin për masat antidamping, atëherë ai në Komision do të jetë në shqyrtimin e dytë.

Fatmir Rexhepi – Propozoi që në mbledhjen e radhës të jetë pikë e rendit të ditës Udhëzimi administrativ nr. 7/2009 për amendamentimin e Udhëzimit administrativ nr. 18/2005 për kontrollin veterinar të importimit, të kalimit transit të produkteve ushqimore dhe joushqimore me origjinë shtazore, të kafshëve të gjalla dhe të materialit për mbarështimin e kafshëve, me arsyetim se është një temë e cila duhet të diskutohet nga Komisioni për shkak të rëndësisë së saj.

Sala Berisha – Shala – Tha se kishte informacion se ky udhëzim i shumëpërfolur tanimë është shfuqizuar dhe është duke u bërë amendamenti i tij. Shtoj se do të ishte e panevojshme të diskutohet për një çështje tanimë të përfunduar apo të ndryshuar.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Në mbledhjen e radhës të jetë në rend dite Udhëzimi administrativ nr. 7/2009 për amendamentimin e Udhëzimit administrativ nr. 18/2005 për kontrollin veterinar të importimit, të kalimit transit të produkteve ushqimore dhe joushqimore me origjinë shtazore, të kafshëve të gjalla dhe të materialit për mbarështimin e kafshëve.
- II. Shqyrtimi në parim i P/ligjit për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani